



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, më 18 mars, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Prokurorisë për pranimin e dëshmisë së një dëshmitari në formë të shkruar, ndërsa dëshmitari do të jetë në dispozicion për t'u marrë në pyetje nga pala jothirrëse. Trupi Gjykses konstatoi se vlera provuese e dëshmisë nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe se mospërputhjet apo kundërshtitë në të mund të diskutohen gjatë pyetjeve të palës jothirrëse. Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se lejimi i dëshmisë në formë të shkruar i kontribuon kryerjes së shpejtë të procesit, sepse shkurton kohën e nevojshme për pyetjet e Prokurorisë nga gjashtë orë në një orë.

Po ashtu më 18 mars, Trupi Gjykses pranoi si prova dëshmitë dhe provat materiale shoqëruese të katër dëshmitarëve vetëm në formë të shkruar, duke konstatuar se provat kishin vlerë provuese dhe nuk shkaktonin dëm të papërligjur, dhe se kriteret për gjykim të drejtë dhe të shpejtë përligjin pranimin e këtyre provave pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse.

Më 13 mars, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë për pranimin e gjashtë deklaratave të dëshmitarëve vetëm në formë të shkruar, meqenëse dëshmitarët kanë ndërruar jetë. Në lidhje me pesë prej deklaratave, Trupi Gjykses miratoi kërkesën, duke konstatuar se provat nuk janë për vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarve dhe se vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve. Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se provat përputhen dhe konfirmohen nga deklaratatë të dëshmitarëve të tjerë të cilët Mbrojtja pati mundësinë t'i merrte në pyetje.

Në lidhje me deklaratën e gjashtë, Trupi Gjykses miratoi kërkesën pjesërisht dhe urdhëroi Prokurorinë të përjashtojë pjesët e dëshmisë në lidhje me një incident që nuk përfshihet në Aktakuzë. Sa i përket pretendimit se disa aspekte të kësaj prove janë spekulative apo të pambështetura, Trupi Gjykses theksoi se kjo do të merret parasysh kur të shqyrtojë peshën dhe vlerën provuese që do t'i japë asaj prove.

Më 17 mars, Mbrojtësi i Viktimave njoftoi Trupin Gjykses se një viktimë vendosi të tërhiqej nga pjesëmarrja në proces për shkak të shqetësimeve për sigurinë. Aktualisht, 154 viktima marrin pjesë në proces në këtë çështje gjyqësore nëpërmjet Mbrojtësit të Viktimave.

Më 13 mars, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, duke konstatuar se vazhdon të ekzistojë rreziku që të akuzuarit të pengojnë procesin dhe/ose të kryejnë vepra





penale të mëtejshme. Trupi Gjykes konstatoi gjithashtu se vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHSK-së, mund të zvogëlohen mjaftueshëm këto rreziqe. Në rastin e z. Selimi, Trupi Gjykes rikujtoi se duket se z. Selimi u nxori informacion të mbrojtur palëve të treta të paautorizuara, dhe se kjo sjellje përforcon konstatimin e Trupit Gjykes se lirimi i z. Selimi përbën rrezik të pengimit të procesit.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 24 mars, në orën 9:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit*, gjatë javës së kaluar u bënë publike disa vendime në lidhje me Aktakuzën në këtë çështje gjyqësore, si dhe në lidhje me operacionet e kontrollimit dhe sekuestrimit të kryera nga Prokuroria.

Në çështjen gjyqësore të Salih Mustafës, dy raporte të Administratores nga maji dhe korriku 2024 në lidhje me zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim, u bënë publike. Në raportet, Administratorja thekson se urdhri i Gjykatësit të Vetëm në lidhje me pagesat për viktimat është zbatuar, në kuptimin që viktimat kanë marrë një përqindje të caktuar të zhdëmtimeve që u janë akorduar. Hollësitë e tjera në lidhje me zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim vazhdojnë të jenë konfidenciale në këtë fazë.

Lidhur me një temë tjetër, DHSK-ja ka marrë disa pyetje nga gazetarë pas vdekjes së babait të Hashim Thaçit, nëse zotit Thaçi do t'i lejohet vizita në Kosovë.

Shfrytëzoj rastin të sqaroj se momentalisht Gjykata nuk është në pozitë të japë informacion për ndonjë kërkesë apo vendim konkret lidhur me këtë pyetje, sepse kërkesat nga një i paraburgosur dhe vendimet mbi ato kërkesa janë gjithmonë fillimisht konfidenciale për arsye siç janë privatësia dhe siguria operative. Pasi të kryhet vizita humanitare, gjykatësit zakonisht i riklasifikojnë këto dokumente, në mënyrë që publiku të mund të informohet më hollësisht. Është me rëndësi të theksohet gjithashtu se, megjithëse këto vizita, kur urdhërohen nga gjykatësit, organizohen sa më shpejtë që është e mundur, kjo mund të marrë kohë, sepse nevojitet bashkërendim i ngushtë me një numër aktorësh dhe organizim logjistik kompleks, përfshirë fluturimet dhe sigurinë.

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e të qenit me familjen në këso raste, korniza ligjore e Dhomave të Specializuara të Kosovës u lejon të paraburgosurve të kërkojnë vizita në Kosovë për arsye humanitare bindëse.

Deri më sot, gjykatësit e Dhomave të Specializuara kanë urdhëruar 13 vizita të tilla.

